

PROCESVERBAL-Tipi I kontratës-PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rehabilitimi i sistemit ushqyes nga rezervuari I Likomilit në rezervuarin e Vraserasë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):45262300-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **97.233.478** (Nëntëdhjetë e shtatë milion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë)lekë pa TVSH **i ndare ne vitet financiare**

Viti 2026: Vlera 19.531.092 (Nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëdhjetë e dy) leke.

Viti 2027: Vlera 29.296.637 (Njëzetë e nëntë milion e dyqint e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqint e tridhjetë e shtatë) leke

Viti 2028: Vlera 48.405.749 (Dyzetë e tetë milion e katërqint e pesë mijë e shtatëqint e dyzetë e nëntë)lekë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Dropull** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese).

2.3 Kapaciteti teknik:

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishit** të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- Kontrate
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtme:

- Kontrate
- Situacionin përfundimtar
- fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore,
- Aktin e kolaudimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore **dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.**

1.1 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

1.2 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

A)Për punimet e përgjithshme në ndërtim :

- **Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi në tokë”.**
- **Kategoria NP-7 Niveli D “Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi e vaditje”**
- **Kategoria NP-4 Niveli A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”**

B) Për punimet speciale të ndërtimit :

- **Kategoria NS-1 Niveli A “Punime për prishjen e ndertimeve”**
- **Kategoria NS-18 Niveli C “ Punime Topogjeodezike.”**

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik¹”te ndryshuar,në të cilët përcaktohet:“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burime të nevojshme** njerëzore e **teknike**,si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021“Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/entikontraktorkërkon:a)**licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr.42 datë 16.01.2008 e ndryshuar“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedura të dhënies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”(lidhja 2,3 dhe 4).Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate,në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar),si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”,AK vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatim të punimeve,kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve,si dhe klasifikimin në nivele të kërkuara për çdo kategori punimesh,kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre,sipas kategorive dhe niveleve (gërmave)përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respective dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Niveli i klasifikimit për kategoritë respective është kërkuar duke u bazuar në zëra të punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008,të ndryshuar.si me poshte :

Kategoritë e licencave me sipër teknikisht argumentohet:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit të fushes</i>	<i>Niveli i klasifikimit të kërkuar për kategorine respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorine perkatëse</i>
NP- 1 A	Punime gërmimi në tokë	<i>0-20 milion</i>	Nuk e kalon vlerën 20 milion
NP-4 A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”	<i>0-20 milion</i>	Nuk e kalon vlerën 20 milion
NP-7-D	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje”	<i>101-200 milion</i>	Nuk e kalon vlerën 200 milion
NS-18-C	Punime topogjeode zike	<i>51 – 100 milion</i>	

--	--	--	--

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 39, pika 6/a, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P-1 A Punime gjurmimi në tokë: Në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjurmime për kanalet, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke

N.P-4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me rehabilitim në rrugë ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke

N.P-7 D Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen për kanal vaditës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-7, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është D. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 200 milion leke

N.S-18 C Punime topogjeodezike: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen Punime topogjeodezike, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Kërkesa për licencë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, të cilat kërkojnë piktet, nivelim dhe kontroll të saktë gjeometrik gjatë zbatimit të projektit kanalit. Kjo licencë garanton kapacitetet teknike për realizimin korrekt të punimeve dhe përputhshmërinë me projektin. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është C.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me

- a. Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet të disponohen nga anetari që do të kryejë shërbimet përkatëse).

Argumentimi: Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në Ligjin nr. 57 /2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 68, pika 2 dhe 3 parashikohet se: “2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. 3. Licenca për veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të këtij neni lëshohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore nga “Qendra Kombëtare e Biznesit”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i licencuar me Kodin III.2.B është e nevojshme sepse gjatë ndërtimit të kanalit krijohen mbetje ndërtimore që duhet të menaxhohen në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar.

Kodet e kërkuara lidhen specifikisht me zërat e punimeve, si punime gjurmimi, prishje, , zëra të cilat shkaktojnë mbetje. Kjo garanton që operatori ekonomik mund të grumbullojë dhe transportojë ligjërisht mbetjet e ngurta të kanalit, duke përfshirë metalet, betonin dhe mbeturinat e tjera të kantierit, duke siguruar siguri mjedisore dhe respektim të rregullave ligjore.

Kjo licencë garanton që operatori: respekton legjislacionin mjedisor; transporton dhe depoziton mbetjet në mënyrë të rregullt; shmang ndotjen dhe problemet për komunitetin dhe siguron organizim e siguri më të mirë në kantier.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt sipas Neni 8**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) *Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.*

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi

Vendimin nr. 448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit” ku përcaktohet se: “1. Detyra e drejtuesit teknik të zbatuesit të punimeve është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2. Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, KREU IV pika 2, germa b) ku përcaktohet: Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi si drejtues teknik dhe ndalohet të disponojë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit; dhe KREU III, pika 3, germa “c” ku përcaktohet se: “Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, *drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese*, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi Transport 1(nje)
- Inxhinier Ndërtimi profili gjeoteknik 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)
- Inxhinier Hidroteknik 1(nje)
- Inxhinier Gjeodet /Markshaidet/Topograf 2 (dy)
- Inxhinier Mjedisi 1(një)

- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

1 Inxhinier Ndërtimi Transport: Referuar preventivi të punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-1, N.P-4**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit Transport**. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit, përfshirë punime ne hapje dhe rregullim rruge aksesit anës kanalit duke garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe cilësinë e punimeve.

2 Inxhinier Hidroteknik: Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-7**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**. Kërkohet për zbatimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit të kanalit, i cili është vepër hidrike.

2 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder: Referuar preventivi të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **N.P-4, N.P-7, NS 18**. Kërkesa për 2 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik është e domosdoshme pasi ai siguron zbatimin e saktë të projektit në terren, duke përcaktuar kordinatat, kuotat, piketimet dhe gjurmën e rrugës orientuar me kuotat e objekteve civile, saktësinë e gjurmës së linjave, volumin e gërmimeve etj. Ata kontrollojnë nivelimet dhe parametrat teknikë gjatë gjithë fazave të punimeve, si dhe realizojnë matjet për volume dhe situacione. Prania e tij garanton cilësi, shmang devijimet nga projekti dhe është thelbësore për realizimin korrekt dhe sipas standardeve të punimeve për gjurmen ku është përcaktuar projekti sipas kuatave që duhen respektuar për vendosjen në funksion të veprës për furnizimin me ujë të fshatrave.

1 Inxhinier Mekanik do të jetë përgjegjës për punimet mekanike ekzistuese në objekt sipas preventivit të punimeve sic janë montimet e pjesëve speciale të celikut, Konstrukcione metalike të thjeshta , etj .

1 Inxhinieri i Ndërtimit profili gjeoteknik: studion vetitë mekanike të tokës dhe përcakton zgjidhjet më të përshtatshme për ndërtimin e kanalit, në mënyrë që të shmangen deformimet, uljet apo çarjet të tokës gjatë hapjeve të kanaleve dhe ndërtimit të veprave të Artit.

Ky inxhinier është përgjegjës për zbatimin e testeve gjeoteknike dhe për të përcaktuar përshtatshmërinë e vendit për ndërtim. Testet ofrojnë të dhëna të çmuara mbi vetitë fizike dhe mekanike të dheut, duke përfshirë llojin, fortësinë, densitetin, përshkueshmërinë, porozitetin dhe kompaktimin, ndër të tjera. Kuptimi i këtyre karakteristikave ndihmon inxhinierët të parashikojnë sjelljen e dheut nën kushte të ndryshme ambientale dhe ngarkesa, dhe i mundëson ata të projektojnë themelin e strukturës në mënyrë efektive dhe të sigurt. Ai udhëzon zgjedhjen e metodës së duhur të ndërtimit dhe materialeve që do të përdoren.

Inxhinier Mjedisi: Referuar preventivi të Punimeve si dhe projektit është e nevojshme prania e këtij inxhinieri për të garantuar që punimet me impakt mjedisor të zbatohen sic duhen.

2.3.6 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Hidrogjeolog 1(nje)

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme)/kontrate bashkepunimi ,librezë pune, C.V.

Argumentim: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

1 Inxhinier Hidrogjeolog: Analizon ndikimin e ujërave nëntokësore mbi strukturën e tunelit egzistues (Vepra e marjes) e kanalit që është parashikuar për tu hapur për të shkuar të vendëburimi i ujit që do të bëhet furnizimi me uje, duke ndihmuar në parandalimin e dëmtimeve që mund të vijnë nga infiltrimi apo lagështia e vazhdueshme.

2.3.7 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1 (një) inxhinjer , i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve / Produkteve te Ndërtimit / Inxhinier Materialeve.**

Personi i mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme/ ose me kontrate bashkepunimi , Diplomë, Librezë pune dhe C.V si edhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit..

Argumentimi:

Është e nevojshme prezenca e një Inxhinieri materialeve pasi në preventiv janë parashikuar punime për materiale të betonit dhe hekurit që do të jenë në prezencë të vazhdueshme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe nën rrezikun faktorët atmosferike , gjithashtu do të bëhet përzgjedhja e materialit që do të furnizohet që është i nevojshme sipas specifikimeve teknike . Rëndësia e cilësisë së materialeve që do të përdoren në këtë objekt është e lartë ndaj lind nevoja e një specialisti për përzgjedhjen dhe vendosjen e tyre në vepër.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (nje) punonjes “Ekspert zjarrfikës”** në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet të paraqitet Certificate/deshmi për ekspert zjarrfikës të leshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrata e punës si dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari që do të kryejë punimet e MNZ.*

- **1 (nje)** Punonjës i Certifikuar si Kordinator I sigurise gjate fazes se punimit ndertimit ne kantier Certificate kordinator per sigurine ne pune. Certificate "Per dhenien e ndihmes se pare, ndihmes se shpejt ", kontratë pune e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar sipas të cilit: “1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, ku citohet se : ”Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpëtimin.**

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **88 (tetedhjete e tete)punonjes**, mesatarisht për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Shenim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të

parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **88 (tetedhjetë e tete) punonjes**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar në baze të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për një periudhë të caktuar të zbatimit të punimeve numri i punonjësve duhet të jete mesatarisht të paktën **88 (tetedhjetë e tete) punonjes**. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Nga llogaritja e orëve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtorë konkludojmë si mëposhtëm:

LLOGARITJA E OREVE TE PUNES

Objekti: Rehabilitimi i sistemit ushqyes nga Rezervuari i Likomelit ne Rezervuarin e Vriserase

Nr	Nr.An	Emertimi Punimeve	Njesi	Sasia	Ore pune njesi	Ore pune total	Dite pune total
I		I. Punime rehabilitimi ne ushqyesin U-1 nga rezervuari I Likomelit					
1	3.2	Prerje bimesh te vogla Φ -10cm	m2	6796	0.08	543.68	67.96
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh 10 - 20	cope	121	0.40	48.40	6.05
3	3.4	Prerje e sistemim pemesh $\varnothing$ 21 - 40	cope	5	1.20	6.00	0.75
4	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	2.5	18.80	47.00	5.88
5	2.258	Nenshtrese zhavorri t=5cm	m3	306	2.90	887.40	110.93
6	3.25/b	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m3	2161	3.60	7,779.60	972.45
7	3.47/1b	Mbushje ngjeshje dheu per bankinat dhe nivelim kanali	m3	2184	0.84	1,834.56	229.32
8	4.1	F+v. Porte metalike (portat e demtuara ne vepren e marrjes)	ton	0.8	45.00	36.00	4.50
9	3.244/1	Beton per kanal C20/25	m3	1001	12.80	12,812.80	1,601.60
10	3.287	F+v. Hekur Φ <10mm, per kanalin	ton	27.7	61.00	1,689.70	211.21
II		2. Punime rehabilitimi ne ushqyesin U-2 nga lumi I Kseries				0.00	0.00
1	3.2	Prerje bimesh te vogla Φ -10cm	m2	20512	0.08	1,640.96	205.12
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh 10 - 20	cope	154	0.40	61.60	7.70
3	3.4	Prerje e sistemim pemesh $\varnothing$ 21 - 40	cope	15	1.20	18.00	2.25
4	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	361.5	18.80	6,796.20	849.53
5	4.1	F+v. Porte metalike(portat e demtuara), cope 3	ton	0.3	45.00	13.50	1.69
6	2.258	Nenshtrese zhavorri t=5cm	m3	477.8	2.90	1,385.62	173.20
7	3.25/b	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m3	2583	3.60	9,298.80	1,162.35
8	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi >2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	1164	0.10	116.40	14.55
9	3.97/b	Germim per nivelim bankinash me esk.0.25m3	m3	150	0.08	12.00	1.50
10	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	1164	0.00	0.00	0.00

11	3.47/1b	Mbushje ngjeshje dheu per bankinat dhe nivelim kanali	m3	2687	0.84	2,257.08	282.14
12	3.46/1	Germim me krah per pastrim vepra arti (ure, tombino)	m3	12	7.05	84.60	10.58
13	3.244	Beton per mure C20/25	m3	433	12.80	5,542.40	692.80
14	3244/1	Beton per kanal C20/25	m3	1710	12.80	21,888.00	2,736.00
15	3.287	F+v. Hekur $\Phi < 10\text{mm}$, per kanalin	ton	53.1	61.00	3,239.10	404.89
16	3.287	F+v. Hekur $\Phi < 10\text{mm}$, per murin	ton	2.37	61.00	144.57	18.07
17	3.288	F+v. Hekur $\Phi > 10\text{mm}$, per murin	ton	46	42.00	1,932.00	241.50
		III. Ndertim vepra arti				80,115.97	10,014.50
		1. Ndertim Prize Tip 40x40 cm	cope	3			
1	3.25/b	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m3	4.44	3.60	15.98	
2	3.47/1b	Mbushje ngjeshje dheu per bankinat dhe nivelim kanali	m3	1	0.84	1.12	
3	3.243	Beton per mure C20/25	m3	3.2	12.80	40.96	
4	4.1	F+v. Porte metalike 40x50 cm	ton	0.053	45.00	2.39	
		Shuma 1 prize				60.45	
		3 priza	cope	3	60.45	181.34	22.67
		2. Ndertim Shkarkues D-80cm					
1	3.25/b	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m3	12	3.60	43.20	
2	3.47/1b	Mbushje ngjeshje dheu per bankinat dhe nivelim kanali	m3	7	0.84	5.88	
3	1.133/p	Tubo betoni Ø 60 cm	ml	3	1.78	5.34	
4	3.243	Beton per mure C20/25	m3	6.7	12.80	85.76	
5	2.258	Nenshtrese zhavorri	m3	1.5	2.90	4.35	
6	3.352	Veshje me gure t=20 cm	m3	0.5	3.40	1.70	
7	4.1	F+v. Porte metalike 60x80 cm	ton	0.081	45.00	3.65	
		Shuma 1 shkarkues				149.88	
		3 shkarkues	cope	3	149.88	449.63	56.20
		3. Ndertim Ure Kembesore HD=2, B=1m	cope	3			
1	3.25/b	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m3	1	3.60	3.60	
2	3.47/1b	Mbushje ngjeshje dheu per bankinat dhe nivelim kanali	m3	1	0.84	0.42	
3	3.243	Beton per mure C20/25	m3	0.7	12.80	8.58	
4	2.258	Nenshtrese zhavorri	m3	1.5	2.90	4.35	
5	3.288	F+v. Hekur $\Phi > 10\text{mm}$, per murin	ton	0.026	42.00	1.09	
6	2.258	Nenshtrese zhavorri	m3	0.08	2.90	0.23	
		Shuma 1 ure				18.27	

		3 ura	cope	3	18.27	54.81	6.85
		4. F+v. Tombino D-1500 mm , L=8ml					
1	3.369	F+v. tombino D-1500 mm, L=8ml	ml	8	15.90	127.20	
		3 cope tombino	cope	3	127.20	381.60	47.70
		SHUMA TOTALE					10,147.92
		AFATI I REALIZIMIT 6 MUAJ (132 DITE PUNE)					132.00
		NUMRI I PUNONJESVE					77.00
		DREJTUES TEKNIK + STAF TEKNIK					11.00
		NUMRI I PUNONJESVE TOTAL					88.00

Ne menyre te permbledhur numri i fuqise puntore qe kerkohet per realizimin e punimeve eshte minimumi 88 (tetedhete e tete)punonjes

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar / të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagese për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit., me profesionet si mëposhtë:

- Teknik Ndërtimi 1 (nje)
- Teknik Gjeodet 1 (nje)
- Hidraulik 1 (nje)
- Muratore 1 (nje)
- Betonues 10 (dhjete)
- Karpentier 8 (tete)
- Hekurkthyes 10 (dhjete)
- Saldator 4 (kater) me deshmi TIG), i certifikuar nga autoritet shqiptare ose te huaja te akredituara
- Punetore te thjeshte 10 (dhjete)

- Të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për te pakten 3 muajt e fundit..
- Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shenim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285,

datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuar në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur **me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme).** Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve:

- **Teknik Ndërtimi:** Kërkohet për mbikëqyrjen e punimeve ditore në terren, organizimin e ekipeve të punës dhe zbatimin korrekt të udhëzimeve të inxhinierëve, duke garantuar cilësinë dhe rendin në punime.
- **Teknik gjeodet:** Tekniku topograf është i domosdoshëm në ndërtimin e një kanali sepse siguron trase të saktë, nivelime korrekte dhe përputhje me projektin. Ai kontrollon gjerësinë, pjerrësinë dhe kuotat e kanalit, duke shmangur gabime që mund të sjellin kosto shtesë dhe probleme .
- **Hidraulik:** Të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas preventivit ku këto punime zënë pjesë të konsiderueshme, sic janë tobinot apo kalimet me tubo.
- **Karpentierë:** Të nevojshëm për ndërtimin e formave për beton, montimin e elementëve druri dhe strukturave të përkohshme, të cilat mbështesin punimet betonit sipas zërave të preventivit.
- **Betonues:** Të nevojshëm për hedhjen dhe nivelimin e betonit në kanale sipas zërave të preventivit
- **Hekurkthyes:** Për prerjen, përgatitjen dhe vendosjen e hekur, pjesë thelbësore e punimeve sic janë ndërtimi i portave, dhe kanalit.
- **Saldator** shërben për bashkimin dhe fiksimin e strukturave metalike si shtyllat mbajtëse, elementeve të ndryshëm metalike sic janë portat etj, duke siguruar që ato të jenë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe ngarkesave të jashtme.
- **Muratore** shërben për realizimin e punimeve të muratures, pjesë e projekt Preventivit sic janë muret e betonit.
- **Punëtorë të thjeshtë:** Për ndihmë në transport materialeve, mbajtje rendi në punime, dhe aktivitetet ndihmëse të nevojshme për realizimin e kontratës, duke mbështetur ekipet teknike dhe specialistët.

Prezenca e këtyre punonjësve në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht :

- **6 punonjës manovratorë** të mjeteve të rënda (3 automakinist dhe 3 eskavatorist) .
- **3 shofer kamioni**.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse. *(Manovratorët mund të disponohen së bashku me mjetet perkatese nese merren me qira).*

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B , operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe shofere, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovratorët, automakinistët dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM–së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operator i ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.

Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Numri dhe kualifikimi i punonjësve të paraqitur në këtë ofertë është përcaktuar në përputhje me mjetet dhe makineritë e deklaruara për realizimin e kontratës. Çdo mjet i parashikuar shoqërohet me personelin përkatës teknik të nevojshëm për operimin e tij, duke garantuar funksionim të pandërprerë dhe efikas gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Konkretisht, numri i shoferëve, manovratorëve, buldozeristit dhe automakinistëve është dimensionuar mbi bazën e numrit dhe llojit të makinerive të angazhuara, për të përballuar ngarkesën e punës dhe çdo situatë operative.

Kjo qasje garanton një shpërndarje optimale të burimeve njerëzore në raport me kapacitetet teknike, duke rritur sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e realizimit të punimeve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në tërësi, këto kërkesa për staf minimal janë të justifikuara nga: Volumi dhe dinamika e punimeve; Nevoja për paralelizëm në procese; Respektimi i afateve kontraktuale; Garantimi i sigurtisë në kantier; Cilësia e zbatimit sipas standardeve të ndërtimit të rrugëve.

Prandaj, vendosja e këtyre kriterëve në dokumentet e tenderit synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të projektit.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri 10-13 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5 - 2 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma (makine teknologjike)	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma me kove para mbrapa(makine teknologjike)	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrom (makine teknologjike)	2 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere me kapacitet mbajtes 2-4 m3 (makine teknologjike)	3 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Nivelues betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektroorgano	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	2 copë	Pronësi ose me qera
Minidumper me kapacitet mbajtes 2-5 ton(makine teknologjike)	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje për hekurkthyes (tranxhe,elektrobango)	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri për shtrim dhe veshje kanali me beton me kove “V” në formë kanali	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompe për largim uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Betoni me Qkl, me distancë jo më larg se 30 km nga kantieri	1 copë	Pronësi ose me qera/Kontrate qeraje

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë

- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Uniforma / Jelek pune 60 cope

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.*
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofruese.*
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim". Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Argumentim Teknik: Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim."

Konkretisht:

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave të largëta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.
- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-13 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave ndërmjetëse më të afërta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.
- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 -5 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave brenda dhe jashtë kantierit në rast nevojë që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit. Gjithashtu shërbejnë dhe për transport Stafi

- **Kamioncinë me kapacitet deri në 1.2 – 2 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit të materialeve të këtij tonazhi kryesisht brenda dhe jashtë kantierit për furnizime.

- **Minidumper** është një mjet i vogël vetëshkarkues, i projektuar për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit ose në terrene të vështira ku nuk mund të lëvizin kamionë të mëdhenj, rruge te ngushta për kthimin e tyre.

- **Kamiona me vinc** është i nevojshëm për transportin e dhe shkarkimin e materialeve, si tuba, cemento, hekur dhe çdo material tjetër që do të përdoret në kantier.

- **Fadromë**, i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit dhe të spostimit të materialeve që do të behen gjatë punimeve.

- **Eskavator me goma** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit, nevoja e një mjeti të tillë si pasojë e punimeve të parashikuara në preventiv.

- **Minifadrome** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit, nevoja e një mjeti të tillë lind si pasojë e punimeve të ngarkimit dhe spostimit të dherave.

- **Autobot uji** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen punimet e lagës se shtresave të betonit dhe pasjes së ujit në objekt.

- **Autobetonierë dhe Autopompë betoni** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen zërat e betonit.

- **Autobetonierë kantieri vetëngarkuese 2.5 - 3.5 m³ i targuar**: përdoret për prodhimin, transportin dhe hedhjen e betonit direkt në kantier, pa nevojë për impiant të jashtëm. Funkcioni vetëngarkues mundëson furnizimin autonom me agregate, çimento dhe ujë, duke rritur efikasitetin dhe ulur kohën e punës. Prania e lejon qarkullimin në rrugë publike për furnizim më të shpejtë. Ajo siguron beton të freskët dhe të përzier në mënyrë të njëtrajtshme, duke garantuar cilësi më të mirë në realizimin e elementeve të kanalit.

Makineri për shtrim dhe veshje kanali me beton me kove “V” në formë kanali është i nevojshëm për ndërtimin e kanalit me forme sa më të rregullt dhe hapje betoni të njëtrajtshëm dhe me përmasa të rregullta pa patur devijime në dimensione.

- **Pajisjet e tjera si, , matrapik, vibrator betoni, gjenerator, pompë uji, Elektrosaldatriçe, Elektroorgano dhe pajisjet e tjera** janë mjete dhe pajisje të lidhura ngushtë me zërat e preventivit.

Fabrike Betoni me Qkl, me distance jo më larg se 30 km nga kantieri është e nevojshme për prodhim betoni për autobetonieret e mëdha, të cilat kanë akses në objekt. Kërkohej jo më larg se 30 km pasi referuar KTZ, betoni në kanale nuk duhet të kalojë shumë kohe nga përgatitja e deri në hedhjen në vepër pasi humbet vetitë fizike të tij. Gjithashtu duke llogaritur dhe llojin e veprës dhe hedhjen e betonit që do të jete me ritme të ulëta pasi nuk ka betonime masive, duhet që fabrika të jete në distance jo më shumë se 30 km nga vepra.

Këto makineri janë të justifikuara sepse: mbulojnë të gjitha fazat e ndërtimit të vepres; mundësojnë punë të njëkohshme në disa fronte; garantojnë cilësi sipas standardeve teknike; ndihmojnë në përmbushjen e afateve kontraktuale dhe rrisin efikasitetin në kantier.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i publikuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë) është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta. Në ndërtimin e rrugëve, ku cilësia e shtresave (bazë, nënbazë, asfalt) është kritike për jetëgjatësinë e investimit, ISO 9001 minimizon rrezikun e defekteve dhe punimeve jashtë standardit.

ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor) ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë) është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 /45001-2023, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 3834-2:2021 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim), kërkohet për të garantuar që saldimet e Konstruksione metalike të perbera, që janë të salduar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë, duke

siguruar qëndrueshmëri strukturore dhe siguri për përdoruesit duke parë që është një veper kanali dhe cilesia duhet te jet e mire standardeve ndërkombëtare .

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim:

Specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi janë hartuar nga projektuesit ne nje dokument te vecante bazuar te objekti i prokurimit dhe jane bashkangjitur te dokumentat e tenderit.

Njesia e Prokurimit